




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.458/2022  
Datë: 24 nëntor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, 1.14 dhe neni 28 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 8 par. 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 08/2022 për Transferimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen 299-të, të mbajtur me datë 24 nëntor 2022, merr këtë:

## V E N D I M

- I. Z. Sulltan Dobraj, gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë dega Deçan, transferohet në mënyrë të përhershëm në Gjykatën Themelore Gjakovë, nga data 1 dhjetor 2022.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 24 nëntor 2022.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 04.10.2022, ka pranuar kërkesë për transferim të përhershëm nga Sulltan Dobraj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan, për në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda. Lidhur me çështjen e transferit në departamentin e krimeve të rënda të Gjykatës Themelore Gjakovë, Këshilli ka pranuar njoftim nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë se ka pozitë të lirë në këtë departament dhe se me rastin e transferimit të tij, do të caktohet në këtë departament.

Në takimin e mbajtur me datë 24 nëntor 2022, Këshilli ka shqyrtuar kërkesën e gjyqtarit Sulltan Dobraj për transfer të përhershëm në Gjykatën Themelore Gjakovë dhe ka vlerësuar se gjyqtari i plotëson kriteret për transferim të përhershëm, prandaj vendosi që gjyqtari Dobraj të transferohet në mënyrë të përhershme nga Gjykata Themelore Pejë dega Deçan në Gjykatën Themelore Gjakovë, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Sulltan Dobraj;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Pejë;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Gjakovë;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.